

L I G J
Nr.8187, datë 23.1.1997

PËR VLERËSIMIN DOGANOR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i vlerës doganore të mallrave me qëllim zbatimin e tarifës doganore, si dhe i masave të tjera jotarifore që mund të vendosen me dispozita të veçanta në fushën e shkëmbimit të mallrave.

Neni 2

Për qëllimet e këtij ligji, termat e përdorura kanë këto kuptime:

1. "Vlera doganore e mallrave të importuara" do të thotë vlera e mallrave për qëllime të nxjerrjes së taksave "ad-valorem" mbi mallrat e importuara.

2. "Vlera e transaktuar" është çmimi aktualisht i paguar ose që do të paguhet për mallrat e shituara për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. a) "Mallra të njëjta" janë mallrat që janë të njëjta në të gjitha aspektet, duke përfshirë karakteristikat fizike, cilësinë dhe emrin e mirë. Diferenca të vogla në pamjen e jashtme nuk i përjashtojnë ato nga përcaktimi si mallra të njëjta.

3. b) "Mallra të ngjashme" janë mallrat që, ndonëse nuk janë të njëjta në të gjitha aspektet, kanë karakteristika dhe materiale përbërëse të ngjashme që i mundëson ato të kryejnë të njëjtat funksione dhe të jenë të zëvendësueshme nga pikëpamja tregtare.

Cilësia e mallrave, emri i mirë i tyre dhe ekzistenca e markave tregtare janë faktorët që merren parasysh nëse mallrat janë të ngjashme.

3. c) Termat "mallra të njëjta" dhe "mallra të ngjashme" nuk përfshijnë mallrat që kanë lidhje me inxhinieringun, zhvillimin, veprat e artit, planimetritë dhe skicat e realizuara në Republikën e Shqipërisë.

3. d) Mallrat nuk do të konsiderohen si "mallra të njëjta" ose mallra të ngjashme", përderisa nuk janë prodhuar në një vend të njëjtë me mallrat që do të vlerësohen.

4. "Mallra të së njëjtës klasë ose lloj" janë mallrat që futen brenda një grupi ose radhë mallrash të prodhuara nga një industri e veçantë ose sektor i veçantë i industrisë dhe përfshijnë mallrat e njëjta a të ngjashme.

5. Me "çmim të paguar" (ose që duhet të paguhet) do të kuptohet pagesa totale e kryer (ose që duhet të kryhet) nga blerësi për shitësin ose për llogari të tij, për mallrat e importuara, dhe përfshin të gjitha pagesat e kryera (ose që duhet të kryhen) nga blerësi për shitësin ose nga blerësi për një palë të tretë, për llogari të një detyrimi që ai mund të ketë ndaj shitësit, si kusht për shitjen e mallrave të importuara. Pagesa mund të mos bëhet patjetër me para në dorë. Pagesa mund të bëhet me letër kredi ose me çdo mjet tjetër, që palët do të bien dakord dhe mund të bëhet direkt ose indirekt.

6. Persona të lidhur janë:

a) Nëpunës ose drejtorë të bizneseve të njëri-tjetrit.

b) Partnerë të njohur ligjërisht në biznes.

c) Punëdhënësi dhe i punësuar.

d) Çdo person që direkt ose indirekt zotëron, kontrollon a mban 5 për qind ose më shumë të votave apo kontributeve në shoqërinë blerëse a shitëse.

e) Një person që direkt ose indirekt kontrollon tjetrin.

- f) Persona që direkt ose indirekt janë të kontrolluar nga një person i tretë.
- g) Persona që së bashku direkt ose indirekt kontrollojnë një person të tretë.
- h) Pjesëtarë të së njëjtës familje.

7. Personat që lidhen në biznes me njëri-tjetrin, në atë mënyrë ku njëri është vetëm agjent, shpërndarës ose komisioner i tjetrit, pavarësisht nga përshkrimi i tyre, do të vlerësohen se janë të lidhur vetëm në qoftë se marrëdhëniet e tyre përfshihen në kriteret e parashikuara në pikën 6.

Neni 3

Detyrimi i importuesve ose eksportuesve për të deklaruar vlerën doganore

Vlera doganore deklarohet në lekë. Përdoret kursi zyrtar i këmbimit të monedhës, i shpallur nga Banka e Shqipërisë, i asaj dite kur bëhet deklarimi në organet doganore.

Neni 4

Metodat e llogaritjes së vlerës doganore

Vlera doganore e bazuar në vlerën e transaktuar të mallrave të importuara

Vlera doganore e mallrave të importuara do të jetë vlera e transaktuar, llogaritur dhe me shtesat sipas dispozitave të nenit 13, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 5.

Neni 5

Vlera e transaktuar nuk do të pranohet si vlerë doganore në qoftë se:

- ekziston ndonjë kufizim për mbajtjen dhe përdorimin e mallrave nga blerësi, që përcakton zonën gjeografike në të cilën mund të shiten mallrat; ose
- shitja apo çmimi i mallrave janë subjekt i kushteve që pengojnë përcaktimin e vlerës së mallrave;
- kur ka rregullime që mund të bëhen në përputhje me nenin 13, ndonjë pjesë e të ardhurave nga rishitja, mbajtja a përdorimi prej blerësit i rikthehet direkt apo indirekt shitësit;
- shitësi dhe blerësi janë të lidhur ndërmjet tyre, në mënyrë që të ndikojë në çmim.

Neni 6

Personat e lidhur

1. Çdo importues i mallrave deklaron me shkrim në organet doganore, në momentin e zhdoganimit, nëse ai është person i lidhur me shitësin.

2. Në rastet kur blerësi dhe shitësi vlerësohen persona të lidhur, duhet të kontrollohen kushtet e shitjes. Vlera doganore do të pranohet me kusht që marrëdhëniet e tyre nuk ndikon në çmimin aktualisht të paguar ose që do të paguhet.

Kur ka fakte që janë persona të lidhur dhe lidhja ka ndikuar në çmim, atëherë organet doganore duhet t'i paraqesin arsyet deklaruesit dhe t'i japin mundësi që ai të përgjigjet. Me kërkesën e deklaruesit, paraqitja e arsyeve bëhet me shkrim.

3. Në shitjen ndërmjet personave të lidhur, vlera e transaksionit si vlerë doganore e mallrave të importuara do të pranohet me kusht që deklaruesi të jetë në gjendje të tregojë se vlera në fjalë përafrohet me vlerat e mëposhtme, të përcaktuara në (ose afërsisht) të njëjtën kohë me:

a) vlerën e transaksionit të mallrave të njëjta (apo të ngjashme) me mallrat që po importohen, të cilat janë shitur për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ndërmjet personave jo të lidhur;

b) vlerën doganore të mallrave të njëjta (apo të ngjashme), të përcaktuar sipas mënyrës që parashikohet në nenin 10.

4. Kriteret e përcaktuara më sipër duhet të përdoren me iniciativën e deklaruesit dhe vetëm për qëllime krahasimi, çka do të thotë që vlerat krahasuese nuk do të zëvendësojnë vlerën e transaksionit.

Neni 7

Vlera doganore e mallrave të njëjta

1. Në qoftë se për arsye të mos plotësimit të kushteve të kërkuara, është e pamundur të zbatohen nenet 4 deri 6, atëherë si vlerë doganore e mallrave të importuara do të pranohet një vlerë transaksioni, e pranuar si vlerë doganore, e mallrave të njëjta që janë importuar në Republikën e Shqipërisë në (ose afërsisht) të njëjtën kohë, në të njëjtin nivel tregtar dhe në (ose afërsisht) të njëjtën sasi.

Në qoftë se një vlerë e tillë nuk mund të gjendet, atëherë lejohen të pranohen vlera të niveleve të ndryshme tregtare.

2. Nëse duke zbatuar këtë nen, gjendet më tepër se një vlerë, si vlerë doganore e mallrave të importuara do të merret më e ulta prej tyre.

Neni 8

Vlera doganore e mallrave të ngjashme

1. Në qoftë se është e pamundur që vlera doganore e mallrave që importohen të përcaktohet në bazë të nenit 7, atëherë si vlerë doganore e mallrave të importuara do të pranohet një vlerë transaksioni, e pranuar si vlerë doganore, e mallrave të ngjashme që janë importuar në Republikën e Shqipërisë në (ose afërsisht) të njëjtën kohë, në të njëjtin nivel tregtar dhe në (ose afërsisht) të njëjtën sasi.

Në qoftë se një vlerë e tillë nuk mund të gjendet, atëherë lejohet të pranohen vlera të niveleve tregtare të ndryshme.

2. Nëse duke zbatuar këtë nen, gjendet më tepër se një vlerë doganore, si vlerë doganore e mallrave të importuara do të merret më e ulta prej tyre.

Neni 9

Radha e zbatimit të vlerës me zbritje dhe të vlerës së llogaritur

1. Në qoftë se është e pamundur që vlera doganore e mallrave që po importohen të përcaktohet në bazë të nenit 8, atëherë vlera doganore e mallrave të importuar do të përcaktohet duke u mbështetur në një nga metodat e treguara në nenin 10 ose 11.

2. Radha e zbatimit të neneve 10 ose 11 mund të zgjidhet nga vetë deklaruesi.

Neni 10

Vlera me zbritje

Vlera doganore e mallrave të importuara mund të bazohet në çmimin për njësi me të cilin, mallrat e importuara ose ato të njëjta apo të ngjashme me to, janë shitur në Republikën e Shqipërisë nga importuesi personave të palidhur, në sasinë më të madhe dhe në (ose afërsisht) të njëjtën kohë, pasi janë bërë zbritjet e duhura për:

a) komisionet e paguara ose që është rënë dakord të paguhen, për fitimin, si dhe për shpenzimet e përgjithshme, që lidhen me shitjet e mallrave të së njëjtës cilësi dhe lloji në Republikën e Shqipërisë;

b) shpenzimet e zakonshme të transportit, ngarkimit, shkarkimit, mbajtjes në dorëzim, përpunimit, sigurimit, si dhe shpenzime të tjera që duhen bërë për t'i sjellë mallrat nga vendi i eksportimit deri në Republikën e Shqipërisë, si dhe

c) të gjitha detyrimet dhe taksat që janë paguar ose që duhet të paguhen në Republikën e Shqipërisë lidhur me importin e mallrave apo me shitjen e tyre.

Neni 11

Vlera e llogaritur

Vlera doganore e mallrave të importuara mund të përcaktohet duke u mbështetur në vlerën e llogaritur, e cila përbëhet nga:

a) kostoja ose vlera e materialeve dhe e proceseve të kryera për prodhimin e mallrave që vlerësohen;

b) fitimi që merret dhe shpenzimet e përgjithshme, që duhet të bëhen zakonisht, nga prodhuesit në vendin e eksportimit për shitjen për eksport në Republikën e Shqipërisë të mallrave të së njëjtës klasë apo lloj me mallrat që po vlerësohen;

c) kostoja apo vlera e elementeve që përmenden në nenin 13.

Neni 12

Metoda e zgjedhjes alternative të vlerësimit doganor

1. Në qoftë se është e pamundur që vlera doganore e mallrave që importohen të përcaktohet duke zbatuar nenet nga 4 deri në 11, atëherë ajo do të përcaktohet mbi bazën e të dhënave që mund të gjenden në Shqipëri, duke përdorur mjete të arsyeshme dhe që janë në përputhje me parimet e përgjigjshme dhe dispozitat e:

- marrëveshjes për zbatimin e nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë (GATT),

- nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë (GATT), dhe

- dispozitave të këtij ligji.

2. Vlera doganore nuk duhet të përcaktohet mbi bazën e paragrafit 1, duke u mbështetur në:

a) çmimin e shitjes në Shqipëri të mallrave të prodhuara në Shqipëri;

b) sisteme që detyrojnë pranimin për vlerë doganore të vlerës më të madhe, ndër dy vlera alternative që mund të gjenden;

c) çmimin e mallrave në tregun e brendshëm në vendin e eksportimit;

d) koston e prodhimit, të ndryshme nga vlera e llogaritur për të cilën flitet në nenin 11;

e) çmimin për eksport drejt një vendi tjetër të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë;

f) vlera doganore minimale; ose

ç) vlera arbitrare apo fiktive.

Neni 13

Shtesa në çmimin aktualisht të paguar ose që do të paguhet

1. Për të përcaktuar vlerën, mbështetur në nenet 4 deri 6, çmimit të paguar ose që duhet të paguhet, për mallrat e importuara duhet t'i shtohen edhe:

a) elementet e mëposhtme, me kusht që ato të jenë kryer nga blerësi dhe nuk janë përfshirë në çmimin e paguar, ose që duhet të paguhet për mallrat e importuara:

i) komisionet dhe pagesat për agjensitë doganore, përveç komisioneve të blerjes,

ii) koston e kontenerëve, të cilët për qëllime doganore, trajtohen si të jenë një me mallin,

iii) koston e paketimit, duke përfshirë punën dhe materialet;

b) vlera e përpjesëtuar në mënyrë të përshtatshme e të gjitha mallrave dhe shërbimeve, të renditura më poshtë, të cilat janë furnizuar, drejtpërdrejt ose jo, nga blerësi pa pagesë ose me një kosto të reduktuar, për qëllime të prodhimit apo shitjes për eksport të mallrave të importuara, në qoftë se kjo vlerë nuk është përfshirë në çmimin e paguar (ose që duhet të paguhet):

i) e materialeve, përbërësve, pjesëve dhe artikujve të ngjashëm, të cilat janë trupëzuar në mallrat e importuara,

ii) e veglave, matricave, kallëpeve dhe artikujve të ngjashëm, që janë përdorur për prodhimin e mallrave të importuara,

iii) e materialeve të konsumuara në prodhimin e mallrave të importuara,

iv) e projekteve inxhinierike, projekteve artistike, planeve, skicave e të tjera si këto, të cilat janë kryer jashtë Republikës së Shqipërisë dhe që kanë qenë të nevojshme për prodhimin e mallrave të importuara;

c) tarifatat e ndryshme për licenca apo ekskluzivitete në lidhje me mallrat e importuara, të cilat blerësi duhet t'i paguajë, drejtpërdrejt ose jo, si kusht për shitjen e mallrave që po vlerësohen, me kushtin që këto tarifa të mos jenë përfshirë në çmimin e paguar (ose që duhet të paguhet);

d) vlera, ose çdo pjesë e saj, e të ardhurave që mund të merren nga rishitja e mëtejshme, mbajtja apo përdorimi i mallrave të importuara, që shkon, drejtpërdrejt apo jo, në përfitim të shitësit;

ç) kostoja e transportit, e ngarkimit, shkarkimit dhe të gjitha operacioneve që lidhen me transportin e mallrave, si dhe ajo e sigurimit të mallrave, për t'i sjellë ato deri në pikën e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Shtesat që duhet t'i bëhen çmimit të paguar (ose që duhet të paguhet) në përputhje me këtë nen, duhet të bëhen mbi bazën e të dhënave sasiore objektive.

3. Asnjë shtesë tjetër nuk duhet t'i bëhet çmimit të paguar (ose që duhet të paguhet), përveçse atyre që janë parashikuar në këtë nen.

4. Shprehja "komisione blerjeje" ka kuptimin e tarifës që një importues i paguan agentit të vet për shërbimin, që ky i fundit i bën duke e përfaqësuar në blerjen e mallrave që po vlerësohen.

5. Në kundërshtim me paragrafin 1 (c):

a) pagesat për të drejtën e riprodhimit të mallrave të importuara në Republikën e Shqipërisë nuk do të shtohen në çmimin e paguar (ose që duhet të paguhet) për mallrat e importuara;

b) pagesat e bëra nga blerësi për të drejtën e shpërndarjes ose të rishitjes së mallrave të importuara nuk duhet të shtohen në çmimin e paguar (ose që duhet të paguhet), në qoftë se këto pagesa nuk janë kusht për shitjen e mallrave për eksport në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Elementet që nuk duhet të përfshihen në vlerën doganore

1. Elementet që vijojnë nuk duhet të përfshihen në vlerën doganore me kusht që të jenë paraqitur veças çmimit të paguar (ose që duhet të paguhet):

a) shpenzimet për transportin e mallrave pas mbërritjes së tyre në pikën e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) shpenzimet për ndërtimin, ngritjen, montimin, mirëmbajtjen apo asistencën teknike që kryhen pas importimit të mallrave të tilla si linja prodhimi industrial, makineri dhe pajisje;

c) pagesat për interesat që rrjedhin nga financime që mund të ketë përfituar blerësi në lidhje me mallrat e importuara, pavarësisht se këto interesa mund të jenë bërë edhe nga vetë shitësi, me kusht që marrëveshja për financim të jetë bërë me shkrim dhe që blerësi të jetë në gjendje të tregojë:

- që këto mallra janë shitur me çmimin që është deklaruar si çmim i paguar ose që duhet të paguhet, dhe

- që interesat e kërkuara nuk e kapërcejnë nivelin e kërkuar për të njëjta lloje transaksionesh, në vendin dhe kohën kur është dhënë financimi;

d) pagesat për të drejtën e riprodhimit në Republikën e Shqipërisë të mallrave të importuara;

e) komisionet e blerjes;

f) taksat doganore të importimit dhe detyrime të tjera që paguhet në lidhje me importimin apo shitjen e mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Ministri i Financave përcakton me një udhëzim të veçantë rregullat për përcaktimin e:

- vlerës doganore të mjeteve mbajtëse të informacionit, që përdoren në pajisjet automatike të përpunimit të të dhënave dhe që përmbajnë të dhëna apo instruksione;

- mënyrës së vlerësimit doganor të mallrave që prishen shpejt.

Neni 16

Dispozitat e këtij ligji nuk prekin dispozitat e veçanta që lidhen me përcaktimin e vlerës doganore të mallrave që çlirohen për qarkullim të lirë, të cilat kanë qenë vendosur në një tjetër rregjim doganor.

Neni 17

Trajtimi i informacionit të besuar

Gjithë informacioni, i cili nga natyra është dhënë me mirëbesim ose sigurohet mbi një bazë të tillë për qëllime të vlerësimit doganor, i nënshtrohet detyrimeve të ruajtjes të karakterit konfidencial

nga autoritetet shqiptare përkatëse, të cilat nuk e japin informacionin pa leje të veçanta të personave ose të qeverisë, vetëm kur ka probleme gjyqësore.

Neni 18

Përcaktimet me shkrim të vlerës

Sipas kërkesës me shkrim, importuesi ka të drejtën e sqarimit me shkrim nga organet doganore të Republikës së Shqipërisë se si është përcaktuar vlera doganore e mallrave të importuara. Një shpjegim i tillë me shkrim i jepet importuesit brenda një kohe prej 5 ditë pune nga data e vlerësimit të mallrave të importuara.

Neni 19

Trajtimi i mallrave të importuara për shtyrje të afatit të vlerësimit doganor

Në qoftë se gjatë përcaktimit të vlerës doganore të mallrave të importuara del e nevojshme shtyrja e afatit në përcaktimin përfundimtar të një vlere doganore, importuesi mund të kërkojë të tërheqë mallrat e tij nga dogana, me kusht që ai të japë garanci të mjaftueshme në formë të sigurimeve, dispozitave apo instrumenteve të tjera të përshtatshme, të barabartë me shumën që duhet të paguante ai për zhdoganimin normal më të lartë të mallrave të importuara prej tij.

Neni 20

E drejta e organeve doganore për të vërtetuar saktësinë e informacionit

Për vërtetësinë ose saktësinë e çdo deklarate a dokumenti për qëllimet e vlerësimit doganor, orgnet doganore kanë të drejtë të bëjnë verifikimet përkatëse.

Neni 21

Ankimi për mënyrën e përcaktimit të vlerës doganore bëhet sipas dispozitave të nenit 72 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

Dispozita të fundit

Ministri i Financave ngarkohet për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse për zbatimin e këtij ligji para hyrjes në fuqi të tij.

Neni 23

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 17 të ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifatat doganore", ndryshuar me ligjin nr.7789, datë 9.2.1994, shfuqizohen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1998.

Shpallur me dekretin nr.1715, datë 31.1.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha